



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 58 pika h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 Qershor 2008, nenit 40 pika h) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që:

Në bazë të nenit 12, dhe nenit 17 paragrafi 1, shkronja (b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, në nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 duke u bazuar në Shkresën përcjellëse të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nr. 1486-2/26 të datës 10.04.2026, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më _____ miratoi këtë:

PROPOZIM

VENDIM

PËR PEZULLIMIN E VENDIMIT 15NR.353/01-13670 I DATËS 31.03.2026 PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR NDRYSHIM PLOTËSIMIN E HARTËS ZONALE TË KOMUNËS

Neni 1

Me këtë Vendim **PEZULLOHET**, Vendimi 15NR.353/01-13670 i datës 31.03.2026, për fillimin e procedurës për ndryshim plotësimin e Hartës Zonale të Komunës.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim-Vendimi është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Statutit të Komunës së Lipjanit si dhe në Shkresën përcjellëse të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Nr.1486-2/26 të datës 10.04.2026.

Me Shkresën përcjellëse të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është kërkuar rishqyrtimi i ligjshmërisë së aktit të lartë duke kërkuar që i njëjti të jetë i bazuar në dokumentet e planifikimit hapësinor të Komunës dhe njëkohësisht kanë kërkuar nga Komuna që ta përmbyll procesin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK).

Përkitazi me këtë konsiderohet e arsyeshme që të bëhet pezullimi i Vendimit të cekur deri në finalizimin e Planit Zhvillimor të Komunës (PZHK).

Nga të cekurat më lartë kërkohet nga Kuvendi i Komunës që me qëllim të përmbushjes së Rekomandimeve të MMPHI deri në finalizimin e Planit Zhvillimor të Komunës (PZHK) të bëjë miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 353/01-18041
Lipjan, më 20.04.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

		REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR		MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA	
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING			
Njësia Org. Org. Jeshikes Org. Unit	DL	Nr. Prot. Org. Prot. Prot. No.	1486-2/26
Nr. i faqes Regjistracion No. pages	-/-	Data Datum Date	10.04.2026
PRISHTINËJA			

Për:	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në MAPL Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Fitore Pacolli Dalipi, Ministre në MMPH Bajram Kafexholli, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPH
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor në VL 41/26 MMPH
Zyrtarët përgjegjës:	Arta Krasniqi - Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Bashkëpunim Ndërinstitucional në Fushën e Përfaqësimeve Gjqësore dhe Koordinim të Marrëveshjeve
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendim Nr. 15-350/01-13670 për fillimin e procedurës për ndryshim plotësimin e Hartës Zonale të Komunës, miratuar nga Kuvendi Komunal i Lipjanit.

I nderuar kryetar Ahmeti,
I nderuar kryesues Azemi

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (Qrk) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 30.03.2026 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Vendimin Nr. 15-350/01-13670 për fillimin e procedurës për ndryshim plotësimin e Hartës Zonale të Komunës, miratuar nga Kuvendi Komunal i Lipjanit.

MMPH pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave kërkon nga Kuvendi Komunal i Lipjanit:

RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT

Vendimin Nr. 15-350/01-13670 për fillimin e procedurës për ndryshim plotësimin e Hartës Zonale të Komunës.


ARSYETIMI

MMPH, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë dhe në pajtim me nenet 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, ka konstatuar se:

- Pjesë e Vendimit duhet të jetë edhe Neni 26 i Ligjit Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor.
- Vendimi duhet të përmbaj arsyetimin për ndryshimin e Hartës Zonale të Komunës, pasi që sipas Ligjit Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor Neni 11. *Përgjegjësit e Autoritetit Përgjegjës Komunal për Planifikim Hapësinor, paragrafi 1. Autoriteti përgjegjës Komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor në pajtim me dispozitat e këtij ligji, është përgjegjës për: nën-paragrafi 1.7. revidim të Hartës Zonale të Komunës katër (4) vite pas miratimit përfundimtar të tij, sipas procedurës së përcaktuar për hartimin dhe miratimin e tyre paraprak, në rast se nga të gjitha masat e parapara në Hartën Zonale të Komunës për këtë periudhë, më pak se dyzet përqind (40%) të jenë zbatuar.*
- Ndryshimi i Hartës duhet të jetë në harmoni me Planin Zhvillimor Komunal sipas Ligjit Nr.04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor Neni 16, paragrafi 3. *Hartimi i Hartës Zonale të Komunës bazohet në: nën-paragrafi 3.4. Hartën Zonale të Kosovës, Planin Zhvillimor Komunal dhe Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.*
- Për kundër obligimit ligjor që Komuna e Lipjanit ka për përgaditjen e Raportit të Zbatimit dhe Monitorimit të Hartës Zonale të Komunës në suaza vjetore, dhe dorëzimit të Raportit informues për gjendjen e zbatimit të Hartës Zonale të Komunës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Komuna e Lipjanit që nga Miratimi i HZK-ës nuk ka dorëzuar çdo vit në MMPH Raport informues për gjendjen e zbatimit të Hartës Zonale të Komunës.

Gjithashtu inkurajojmë Komunën e Lipjanit që sa më parë ta përmbyll procesin e hartimit të PZHK-së në mënyrë që mos të ketë pengesa në procedurat për plotësim ndryshimin e Hartës Zonale të Komunës.

Nga ajo që u tha më lartë, të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit Komunalit të MMPH, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, të më vonë se afati i paraparë në dispozitat e Ligjit Nr. 08/ L-284 për Shqyrtimin Administrativ të



Akteve të Komunave dhe Rregullores (Qrk) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave.

